

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Bazat e Auditimit të
Brendshëm**

B2

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 01.08.2020

CONTENT/ PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i dhënë	Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK PIKËT E DHËNA
1. Pyetje (50 x 2 pikë)	100	
Gjithsej	100	

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

1. Cila nga sa vijon është unike për vlerësimin e jashtëm të veprimtarisë së një auditimi të brendshëm në krahasim me vlerësimin e brendshëm?
 - a) Ndjekja (Follow-up)
 - b) Gjetjet
 - c) Përgjigjet nga shefi ekzekutiv i auditimit**
 - d) Rekomandimet

2. Nëse auditorët e brendshëm përdoren si "burime të huazuara" për një njësi biznesi, kjo mund të çojë në cilën nga sa vijon?
 - a) Rreziku i biznesit.
 - b) Dështimet e auditimit.
 - c) Sigurimi i rremë i auditimit.**
 - d) Rreziku i reputacionit të auditimit.

3. Cila nga sa vijon NUK është një deklaratë e vërtetë në lidhje me marrëdhëniet midis auditorëve të brendshëm dhe auditorëve të jashtëm?
 - a) Mbikëqyrja e punës së auditorëve të jashtëm është përgjegjësi e drejtorit të auditimit të brendshëm.**
 - b) Mund të ketë takime periodike ndërmjet auditorëve të brendshëm dhe të jashtëm për të diskutuar çështje me interes të ndërsjellë.
 - c) Mund të ketë një shkëmbim të raporteve të auditimit dhe letrave të menaxhimit ndërmjet auditorëve të brendshëm dhe të jashtëm.
 - d) Auditorët e brendshëm mund të ofrojnë programe auditimi dhe letra pune për auditorët e jashtëm.

4. Një anëtar i ri të ekipit të auditimit i'u kërkuar të kryente një auditim në një fushë me të cilën auditori nuk ishte i njohur. Për shkak të kufizimeve kohore, nuk ka pasur mbikëqyrje të auditimit. Auditorit i' u dha detyra sepse përfaqësonte një mundësi të mirë për të mësuar, por fusha e auditimit ishte qartë përtej kompetencës së auditorit. Sidoqoftë, auditori përgatiti letra gjithëpërfshirëse të punës dhe raportoi rezultatet tek menaxhmenti. Në këtë situatë:
 - a) Departamenti i auditimit ka shkelur Standardet IIA duke punësuar një auditor pa përvojë në këtë fushë.
 - b) Departamenti i auditimit shkelti Standardet IIA duke mos siguruar mbikëqyrje adekuate.**
 - c) Shefi ekzekutiv i auditimit nuk ka shkelur Kodin e Etikës pasi që Kodi nuk adreson mbikëqyrjen.
 - d) Standardet IIA dhe Kodi i Etikës janë ndjekur nga departamenti i auditimit.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

5. Drejtori i auditimit të brendshëm të një ndërmarrje të mesme të auditimit të brendshëm ishte i shqetësuar që menaxhmenti mund të transferojë funksionin e auditimit të brendshëm. Prandaj, menaxheri miratoi një program shumë agresiv për të promovuar departamentin e auditimit të brendshëm brenda organizatës. Menaxheri planifikoi t'i paraqiste rezultatet para menaxhmentit dhe komitetit të auditimit dhe të rekomandojë modifikimin e statutit të auditimit të brendshëm pas përdorimit të programit të ri. Gjashtë veprime që menaxheri i auditimit ndërmori për të promovuar një imazh pozitiv brenda organizatës, janë renditur në vijim:

- I. Detyrat e auditimit u përqendruan në auditimet e ekonomisë dhe efikasitetit. Auditimet u përqendruan vetëm në kursimet e kostos, dhe secili raport i auditimit nënvizoi kostot e mundshme për tu kursyer. Gjetjet negative ishin lënë anash. Fokusimi në auditimet e ekonomisë dhe efikasitetit ishte i ri, por auditorët dukeshin shumë të lumtur.
- II. Hartimet e të gjitha raporteve të auditimit u shqyrtuan me kujdes me auditorët për të marrë kontributin e tyre. Komentet e tyre u morën me kujdes gjatë përpilimit të raportit përfundimtar të auditimit.
- III. Auditori i teknologjisë së informacionit mori pjesë si pjesë e ekipit të zhvillimit për të rishikuar procedurat e kontrollit për t'u përfshirë në një aplikacion kryesor kompjuterik në zhvillim.
- IV. Duke pasur parasysh burime të kufizuara, menaxheri i auditimit kreu një analizë të rrezikut për të përcaktuar se cilat lokacione duhet të auditohen. Kjo ishte një largim i dukshëm nga qasja e mëparshme për të siguruar që të gjitha operacionet të rishikohen në të paktën një interval tre vjeçar.
- V. Për të kursyer kohë, menaxheri nuk kërkonte më që të plotësohej një pyetësor standard i kontrollit të brendshëm për secilin auditim.
- VI. Kur auditorët zbuluan se menaxhmenti dhe pala e audituar nuk kishin krijuar kritere ose të dhëna specifike për të vlerësuar operacionet e palës së audituar, ekipi i auditimit ishte udhëzuar që të kryejë hulumtime, të zhvillojë kritere specifike, të rishikojë kriteret me auditorin, dhe nëse është e pranueshme, t'i përdorë ato për të vlerësuar veprimet e palës së audituar. Nëse pala e audituar nuk pajtohej me kriteret, do të zhvillohej një bisedim derisa të merreshin vesh kriteret e pranueshme. Raporti i auditimit ka komentuar veprimet e auditorit në lidhje me kriteret e rënë dakord.

A është veprimi 5 shkelje e standardeve të IIA?

- a) Po. Kontrolli i brendshëm duhet të vlerësohet në çdo auditim, por pyetësori i kontrollit të brendshëm nuk është qasja e mandatuar për të vlerësuar kontrollet.
- b) Jo. Auditorët mund të lënë procedurat e nevojshme nëse ekziston një kufizim kohor. Është çështje e gjykimit të auditimit.
- c) Po. Kontrolli i brendshëm duhet të vlerësohet në çdo angazhim të auditimit, dhe pyetësori i kontrollit të brendshëm është metoda më efikase për ta bërë këtë.
- d) Jo. Auditorët nuk kërkohet të plotësojnë pyetësorët e kontrollit të brendshëm për çdo auditim.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

6. Cila nga marrëdhëniet e mëposhtme përshkruan më së miri përgjegjësinë e duhur të raportimit të dyfishtë të auditorit të brendshëm? Administrativisht tek:
 - a) Bordi i drejtorëve, funksionalisht te drejtori ekzekutiv.
 - b) Kontrolluesi, funksionalisht te zyrtari kryesor financiar.
 - c) Drejtori ekzekutiv, funksionalisht në bordin e drejtorëve.**
 - d) Drejtori ekzekutiv, funksionalisht te auditori i jashtëm.

7. Kur përcaktohet numri dhe niveli i përvojës së stafit të auditimit të brendshëm që do të caktohet për një auditim, kryeshefi i auditimit duhet të marrë parasysh të gjitha sa vijon, përveç:
 - a) Kompleksiteti i detyrës së auditimit.
 - b) Burimet e disponueshme të auditimit.
 - c) Nevojat për trajnim të auditorëve të brendshëm.
 - d) Koha e kaluar që nga auditimi i fundit.**

8. Sipas Standardeve IIA, cili nga sa vijon është renditja e saktë e informacionit që duhet të përfshihet në një raport mashtrimi?
 - a) Qëllimi, fushëveprimi, rezultatet dhe, kur është e përshtatshme, shprehja e opinionit të auditorit.
 - b) Kriteret, gjendja, shkaku dhe efekti.
 - c) Historiku, gjetjet dhe rekomandimet.
 - d) Gjetjet, përfundimet, rekomandimet dhe veprimet korrigjuese.**

9. Sipas Standardeve IIA, auditorët e brendshëm duhet të rishikojnë mënyrat e mbrojtjes fizike të pasurive nga humbjet që vijnë nga:
 - a) Keq zbatimi i parimeve të kontabilitetit.
 - b) Procedurat që nuk justifikojnë kostot.
 - c) Ekspozimi ndaj elementeve.**
 - d) Mos përdorimi i plotë i hapësirës fizike.

10. Ndërsa kryen një auditim në ndërtimitari, auditori dyshon se çeliku strukturor i përdorur nuk përputhet me specifikimet e kontratës. Departamenti i auditimit të brendshëm nuk ka në staf një inxhinier. Sipas Standardeve IIA, mënyra e duhur e veprimit është:
 - a) Caktimi një vlerë monetare në diferencë dhe përgatitni një konstatim të mangësisë.
 - b) Pyetni një kompani ose një inxhinjer për të përcaktimi nëse çeliku përputhet me specifikimet e kontratës.**
 - c) Kërkoni nga mbikëqyrësi i ndërtimit të shpjegojë pse ka një ndryshim.
 - d) Kërkoni pezullimin e pagesave të kontratës deri sa të zgjidhet ndryshimi.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

11. Gjatë auditimit të një divizioni prodhues të një kontraktori të mbrojtjes, auditori hasi në një skemë që dukej sikur kompania po shtonte në mënyrë jo të duhur kosto në një kontratën qeveritare. Auditori diskutoi metodën me menaxhmentin e lartë, i cili sugjeroi që auditori të kërkojë një mendim nga këshilltari juridik. Auditori e bëri këtë. Pas rishikimit të kontratës me qeverinë, avokati tregoi se praktika ishte e diskutueshme por jo teknikisht në kundërshtim me kontratën e qeverisë. Bazuar në vendimin e këshilltarit juridik, auditori vendosi të heqë çdo diskutim mbi praktikën në raportin zyrtar të auditimit që shkoi për menaxhmentin dhe komitetin e auditimit, por komunikoi në mënyrë joformale menaxhmentit vendimin e këshilltarit ligjor. A e ka shkelur auditori Kodin e Etikës IIA?
- a) **Jo. Auditori e ndoqi çështjen me personelin e duhur brenda organizatës dhe arriti në përfundimin se nuk ishte përfshirë ndonjë mashtrim.**
 - b) Jo. Nëse dyshohet për mashtrim, ai duhet të zgjidhet në nivelin divizional ku po zhvillohet.
 - c) Po. Është shkelje sepse të gjitha informacionet e rëndësishme, edhe nëse zgjidhen, duhet t'i raportohen komitetit të auditimit.
 - d) Po. Mendimi i brendshëm i këshilltarit ligjor nuk është i mjaftueshëm. Auditori duhet të ketë kërkuar këshilla nga këshilltar të jashtëm juridik.
12. Qëllim kryesor për krijimin e një kodi të sjelljes brenda një organizate profesionale është:
- a) Zvogëlon mundësinë që anëtarët e profesionit të paditen për punë nën standarde.
 - b) Sigurohun që të gjithë anëtarët e profesionit të performojnë përafërsisht në njëjtin nivel të kompetencës.
 - c) **Demonstron pranimin e përgjegjësisë për interesat e atyre që shërbehen nga profesioni.**
 - d) Kërkon nga anëtarët e profesionit të shfaqin besnikëri në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me punët e organizatës së tyre.
13. Gjatë një auditimi, një punonjës me të cilin keni zhvilluar një marrëdhënie të mirë pune ju informon se ajo ka disa informata në lidhje me menaxhimin e lartë, të cilat mund të jenë të dëmshme për organizatën dhe mund të kenë të bëjnë me veprimtari të paligjshme. Punonjësja nuk dëshiron që emri i saj të shoqërohet me dhënien e informacionit. Cila nga veprimet e mëposhtme do të konsiderohej në kundërshtim me Kodin e Etikës dhe Standardeve IIA?
- a) **Sigurojeni punonjësit që ju mund të mbani anonimatin e saj dhe të dëgjoni informacionin.**
 - b) Sugjeroni që personi të marrë parasysh bisedën me këshilltar ligjor.
 - c) Informoni individin që do të përpiqeni të mbani konfidenciale burimin e informacionit dhe do të shqyrtoni çështjen më tej.
 - d) Informoni punonjësën për metodat e tjera të komunikimit të këtij lloji të informacionit.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

14. Standardet e sjelljes të përcaktuara në Kodin e Etikës IIA:

- a) **Sigurojnë parimet themelore në praktikën e auditimit të brendshëm.**
- b) Janë udhëzime për të ndihmuar auditorët e brendshëm në trajtimin me palët që auditohen.
- c) Janë rregulla që duhet të respektohen në të gjitha rrethanat.
- d) Sigurojnë një kuptim të përgjithshëm të përgjegjësisë së auditimit të brendshëm.

15. Një anëtarë i ekipit të auditimit është caktuar në auditimin e thesarit për të dytin vit radhazi. Auditori konfirmoi letrat me vlerë të investimeve të mbajtura nga një kompani ndërmjetësuese (broker) dhe kuptoi se disa letra me vlerë të madhe u përdorën si kolateral për kredi personale disa vjet më parë nga thesaristi aktual. Vitin e kaluar, auditori gabimisht kishte nënshkruar në hapat e auditimit që përfshijnë konfirmimet dhe verifikimin e letrave me vlerë, pa i kryer të gjitha hapat. Menaxheri i auditimit gjithashtu gabimisht u nënshkrua në rishikim të punës në vitin e kaluar. Kur u zbulua gabimi këtë vit, menaxheri i auditimit komentoji se "Ishte një gabim, por kredia është shlyer, dhe letrat me vlerë u kthyen. Ne kemi korrigjuar dobësinë e kontrollit, dhe unë jam pozitiv që nuk do të ndodhë përsëri. Ndjekja e kësaj çështje do të jetë telashe për të gjithë të përfshirët. Lëreni ashtu siç është. "

Si anëtarë i ekipit të auditimit, cila nga veprimet e mëposhtme do të konsiderohej shkelje e Standardeve IIA ose Kodit të Etikës?

- a) Informimi i menaxherit të auditimit se do të përfshini informacionin në dokumentet tuaja të punës si gjetje e auditimit.
- b) Diskutimi i çështjes me shefin ekzekutiv të auditimit pa diskutim të mëtejshëm me menaxherin e auditimit.
- c) **Shpalosja e çështjes tek auditori i jashtëm pa diskutim të mëtejshëm.**
- d) Dorëheqja nga departamenti i auditimit dhe ndërmarrja nëse nuk ndërmerren veprime të mëtejshme për çështjen.

16. Gjatë një auditimi, një Auditor i Brendshëm i Certifikuar (ABC) mësoi se individë të caktuar në organizatë ishin përfshirë në spiunazh industrial për të përfitim të organizatës. Sipas Kodit të Etikës IIA, identifikoni mënyrën e veprimit të auditorit.

- a) **Raportoni faktet tek individët e duhur brenda organizatës.**
- b) Nuk kërkohet asnjë veprim pasi kjo gjendje nuk është e dëmshme për organizatën.
- c) Vini re gjendjen në dokumentet e punës, por përmbahuni nga raportimi sepse i sjell përfitime organizatës.
- d) Raportoni gjendjen në agjencinë e duhur rregullatorë të qeverisë.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

17. Gjatë kryerjes së një auditimi operativ të ciklit të prodhimit të firmës, një auditor i brendshëm zbulon se, në mungesë të udhëzimeve specifike, disa inxhinierë dhe blerës pranojnë në mënyrë rutinore udhëtime pushimesh të paguara nga disa prej shitësve të firmës. Inxhinierët dhe blerësit e tjerë nuk do të pranojnë as një drekë pune të paguar nga një shitës. Cilin nga veprimet e mëposhtme duhet të ndër marrë auditori i brendshëm?
- a) Asnjë. Inxhinierët dhe blerësit janë profesionistë. Është e papërshtatshme që një auditor i brendshëm të ndërhyjë në atë që është në thelb një vendim personal.
 - b) Këshilloni në mënyrë joformale inxhinierët dhe blerësit që pranojnë udhëtimet e pushimeve. Kjo ndihmon në parandalimin e mundësisë së goditjeve, ndërsa ruhen marrëdhënie të mira auditor/ palë e audituar.
 - c) Rekomandoni zyrtarisht që ndërmarrja të krijojë një kod etik të korporatës. Udhëzimet e sjelljes së pranueshme brenda të cilave mund të merren vendime individuale duhet të sigurohen.**
 - d) Nxjerrni një raport zyrtar të mungesës, duke emëruar personelin që pranon pushimet, por nuk jepni rekomandime. Veprimi korrigjues është përgjegjësi e menaxhmentit.
18. Cila nga deklaratat e mëposhtme NUK është e përshtatshme për t'u përfshirë në politikën e konfliktit të interesit të një prodhuesi? Një punonjës nuk duhet:
- a) Pranoj para, dhurata ose shërbime nga një klient.
 - b) Merr pjesë (direkt ose indirekt) në menaxhimin e një kompanie publike.**
 - c) Huazoj para ose jep hua shitësve.
 - d) Përdorë informacionin e kompanisë për qëllime private.
19. Kodi etik i një firme përmban deklaratën e mëposhtme: "Punonjësit nuk do të pranojnë dhurata ose pagesa më të larta se €50 nga persona ose firma me të cilët ndërmarrja jonë bën biznes." Kjo dispozitë është krijuar për të parandaluar:
- a) Devijimin me fonde të kompanisë nga punonjësi.
 - b) Shitjet me kredi të tepërta të dhëna nga një punonjës.**
 - c) Mosarritja e një punonjësi për të regjistruar arkëtimet e parave.
 - d) Pjesëmarrja nga një punonjës në një drekë pune të financuar nga një furnizues i firmës.
20. Arsyeja më e mirë për krijimin e një kodi të sjelljes brenda një ndërmarrje është që kode të tilla:
- a) Kërkohen nga Ligji i Praktikave të Korruptuara.
 - b) Pasqyrojnë standardet e sjelljes individuale për anëtarët e organizatës.**
 - c) Sigurojnë një bazë të matshme për vlerësimet e personelit.
 - d) Kanë potencial të jashtëzakonshëm për marrëdhëniet me publikun.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

21. Menaxheri i operacioneve të një kompanie njoftoi departamentin e thesarit të kompanisë 60 ditë më parë se një pjesë e re, e shtrenjtë e makinerive do të blihej. Ky njoftim i lejoi thesarit të bënte një likuidim të rregullt të disa prej portofolit të investimeve të kompanisë me kushte të favorshme. Zgjidhni llojin e kontrollit që përshkruan ky shembull.
- a) Kontroll reaguese (Feed-back)
 - b) Kontroll Strategjike
 - c) Kontroll buxhetore
 - d) Kontroll parandaluese (Feed-forward)**
22. Kur planifikonte rishikimin e kontrolleve të aplikacionit për përdoruesit të fundit (EUC), auditori i brendshëm zgjodhi të përfshijë mjedisin e kontrollit të përgjithshëm në fushëveprim. Cila nga deklaratat e mëposhtme në lidhje me kontrollet e përgjithshme është më e mundshme që auditori ta gjykojë të vërtetë?
- a) Efektiviteti i kontrolleve të përgjithshme ndikohet nga kontrollet e aplikacionit.
 - b) Identifikimi i personit ose i funksionit përgjegjës për kontrollet e përgjithshme mund të jetë më e lehtë këtu sesa në një mjedis tradicional të veprimit.
 - c) Nevoja për kontrolle specifike të përgjithshme është relativisht e vazhdueshme në mjediset e EUC.
 - d) Kontrollet e përgjithshme duhet të jenë të vendosura përpara se kontrollet e aplikimit të mund të mbështeten.**
23. Për të siguruar kompletimin e një azhurnimi të skedarëve, departamenti i përdoruesve ruan kopjet e të gjithë dokumenteve të pa-numërtuar të paraqitur për përpunim dhe i verifikon këto individualisht kundër një raporti të transaksioneve të përpunuara. Ky është një shembull i përdorimit të:
- a) Vendosija e totalit të grupeve
 - b) Kontrollit Një - për - një**
 - c) Kontrollet e sekuencës kompjuterike.
 - d) Përshtatja e kompjuterit.
24. Për tu siguruar që një fushë e veçantë e të dhënave të ruhet siç duhet, postimet manuale të totalit të grupeve për atë fushë në një llogari kontrolli:
- a) Nuk kanë asnjë vlerë në mirëmbajtjen e skedarëve.
 - b) Duhet të krahasohen në mënyrë periodike me skedarin master të kompjuterit.**
 - c) Qëndrojnë vetëm si kontroll.
 - d) Duhet të përdoret në kombinim me totalet hash.
25. Përdoruesit e COSO përdorin cilën nga proceset e mëposhtme të vlerësimit të kontrollit?
- a) Një-shtresore
 - b) Dy-shtresore**
 - c) Tre-shtresore
 - d) Katër-shtresore

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Grumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

26. Qasja e auditimit bazuar në COSO NUK duhet të tejkalojë cilën nga sa vijon?
- a) **Qasjen e bazuar në rrezik.**
 - b) Qasjen e bazuar në transaksione.
 - c) Qasjen e bazuar në menaxhim.
 - d) Qasjen e bazuar në komitetin e auditimit.
27. Sipas raportit të COSO, korniza e kontrollit të brendshëm përbëhet nga cila nga sa vijon?
- a) **Proceset, njerëzit, objektivat.**
 - b) Fitimet, produktet, proceset.
 - c) Kostot, të ardhurat, marzhet.
 - d) Kthimi i investimit, fitimet për aksion, pjesa e tregut.
28. Cila nga levat e mëposhtme të kontrollit krijojnë forca pozitive dhe inspiruese në një ndërmarrje?
- I. Sistemet e besimit
 - II. Sistemet e kontrollit interaktiv
 - III. Sistemet kufitare
 - IV. Sistemet e kontrollit diagnostikues
- a) **I dhe II**
 - b) II dhe III
 - c) III dhe IV
 - d) II dhe IV
29. Menaxherët e lartë më së shpeshti përdorin cilat nga se vijojnë për të arritur objektivat e tyre të biznesit?
- a) Kontrollat e forta, rishikimet e palëve të treta dhe aftësi të forta.
 - b) **Kontrollet e buta, vetëvlerësimet dhe aftësitë e buta.**
 - c) Kontrollet e buta, rishikimet e palëve të treta dhe aftësi të buta.
 - d) Kontrollet e forta, vetëvlerësimet dhe aftësitë e forta.
30. Sipas raportit të COSO, për një politikë që të zbatohet, NUK ka nevojë të jetë e:
- a) **Shkruar**
 - b) E menduar mirë
 - c) Qartë
 - d) Qëndrueshme
31. Sipas raportit të COSO, cili nga sa vijon NUK është parakusht për kontrollin e brendshëm?
- a) Vendosja e objektivit
 - b) Planifikim strategjik
 - c) Menaxhimi i rrezikut
 - d) **Monitorimi**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

32. Cila nga fjalitë e mëposhtme karakterizon me korrektësi literaturën e flamujve sinjalizues (të kuq) që është zhvilluar së fundmi në profesionin e auditimit?
- I. Flamujt sinjalizues (të kuq) janë sende ose veprime që janë shoqëruar me sjellje mashtruese.
 - II. Auditori duhet të dokumentojë të gjitha flamujt e kuq që mund të jenë identifikuar në një angazhim auditimi.
 - III. Shumë flamuj të kuq janë natyrë subjektive dhe mund të mos vërehen nga auditori gjatë një auditimi që është planifikuar dhe kryer siç duhet në përputhje me Standardet.
- a) I dhe II
 - b) I dhe III**
 - c) II dhe III
 - d) Vetëm III
33. Një programues që grumbullon gabime në një llogari që më vonë çaset/hapet nga programuesi është një lloj mashtrimi kompjuterik. Mënyra më e mirë për të parandaluar këtë lloj mashtrimi është:
- a) Ndërtoni gjykimin me teste të arsyeshmërisë.
 - b) Testoni në mënyrë të pavarur programet gjatë zhvillimit dhe kufizoni hyrjen në programe.**
 - c) Detyrat e ndara të zhvillimit dhe programimit të sistemeve.
 - d) Përdorni totalitetin e kontrollit dhe kontrolloni rezultatet e kompjuterit.
34. Një mashtrim u krye në një kompani me madhësi të moderuar kur nëpunësit të kontabilitetit i' u delegua shumë përgjegjësi. Gjatë vitit, kompania kaloi furnizuesit e një shërbimi tek një shitës i ri. Punonjësi i kontabilitetit vazhdoi të paraqiste fatura mashtruese nga furnizuesi i vjetër. Për shkak se kontraktimi për shërbime dhe miratimi i faturave të furnizuesve i ishte deleguar nëpunësit, ishte e mundur që ai të vazhdonte faturimet nga furnizuesi i vjetër dhe të depozitonte çekun e mëvonshëm me postë, për të cilin ai ishte përgjegjëse, në një llogari të re që ai hapi në emër të furnizuesit të vjetër. Nëpunësi u konsiderua një punonjës i shkëlqyeshëm dhe përfundimisht i' u dha përgjegjësia e shtuar për përgatitjen e buxheteve të departamentit. Kjo përgjegjësi e shtuar i lejoi atij që në të vërtetë të buxhetojë për shumën e pagesave mashtruese.
- Cili nga kontrollet e mëposhtme do të ishte më pak i mundshëm për të parandaluar ose zbuluar mashtrimin e përshkruar më sipër?
- a) Kërkoni autorizimin e pagesave nga dikush tjetër përveç nëpunësit që negocion kontratën.
 - b) Krahasimi nga personi që nënshkruan çekun e faturave me një verifikim të pavarur të shërbimeve të bëra.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

- c) Përgatitja e buxhetit nga një person tjetër përveç personit që nënshkruan kontratën dhe aprovon pagesa.
- d) Dërgimi i çekut nga një person tjetër nga personi përgjegjës për nënshkrimin e çekut ose miratimin e faturës.**
35. Nëse të gjithë faktorët e tjerë të planifikimit të madhësisë së mostrës ishin saktësisht të njëjtë në përzgjedhjen e mostrave, ndryshimi i nivelit të besimit nga 95% në 90% dhe ndryshimi i saktësisë së dëshiruar nga 2% në 5% do të rezultonte në një madhësi të rishikuar të mostrës që do të ishte:
- a) Më e madhe.
- b) Më e vogël.**
- c) E Pandryshuar.
- d) E Papërcaktuar.
36. Një auditor po teston në skedarin e madhe arkëtimet e zakonshme të një kompanie. Objektivat e auditimit janë të testojnë bilancet monetare të arkëtuara pranë fundvititi dhe normat e përjashtimit (gabimit) të llogarive të arkëtueshme. Për të testuar skedarin e arkëtueshëm për të llogaritur një total të vlerësuar monetar, auditori mund të përdorë cilëndo nga teknikat e mëposhtme të marrjes së mostrave përveç:
- a) Vlerësimi i diferencës ose proporcionit
- b) Vlerësimi mesatar për - për njësi i jo shtresuar.
- c) Probabiliteti në përpjesëtim me madhësinë.
- d) Atributet**
37. Është bërë auditimi i llogarive të pagueshme për të përcaktuar nëse niveli i gabimit ishte brenda politikës së deklaruar prej 0.5%. 100 nga 10,000 transaksionet e llogarive të pagueshme u zgjedhën rastësisht duke përdorur një nivel besimi 95%. Nuk u gjetën gabime. Me 95% siguri mund të konkludohet se rezultatet nga mostra:
- a) Tregojnë se një mostër tjetër është e nevojshme.
- b) Vërtetojnë se nuk ka gabime në llogaritë e pagueshme.
- c) Tregojnë që hipoteza pa gabime është jo e saktë
- d) Dështojnë të vërtetojnë që shkalla e gabimit është mbi 0.5%.**
38. Në zgjedhjen e një mostre të artikujve për testimin e variablave, një auditor duhet të marrë parasysh saktësinë e dëshiruar, devijimin standard, dhe:
- a) Vlerat monetare të regjistruar në popullacion.
- b) Nivelin e pranueshëm të rrezikut.**
- c) Shkallën e pritjes së ndodhjes.
- d) Intervalin e marrjes së mostrave.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

39. Një auditor po përdor metodën e njësisë monetare për përzgjedhjen e mostrës me një interval fiks për të testuar një llogari me një bilanc prej €750,000. Madhësia e mostrës është 50. Auditori filloi procesin e përzgjedhjes me një fillim të rastësishëm të 04719. Cila nga pikat e mëposhtme do të ishte zëri i tretë i përzgjedhur?

- a) Shuma e faturës €7,985; Shuma kumulative €31,374
- b) Shuma e faturës €4,108; Shuma kumulative €35,482**
- c) Shuma e faturës €12,305; Shuma kumulative €47,787
- d) Shuma e faturës €456; Shuma kumulative €48,243

Shuma kumulative është shuma e parë më e madhe se €34,719, që do të ishte pragu për zgjedhjen e tretë (d.m.th., €4,719 + €15,000 + €15,000). Intervali i përzgjedhjes është €750,000 / 50 = €15,000. Ai përmban €31.375 deri në €35,482, pra përmban €34,719.

40. Cila nga sa vijon është e vërtetë për një skicë horizontale në krahasim me një skicë vertikale?

- a) Ajo siguron më shumë hapësirë për përshkrime të shkruara që paralelizojnë simbolet.
- b) Ajo sjell në fokus më të qartë caktimin e detyrave dhe kontrollet e pavarura në performancë.**
- c) Zakonisht është më e gjatë.
- d) Ajo nuk jep një pamje më të gjerë në shikim të parë

41. Menaxheri i blerjes së një kompanie prodhuese ishte i shqetësuar me rritjen e çmimeve të disa materialeve direkte të siguruar nga një furnizues. Menaxheri i blerjes i tha furnizuesit ose të ruajë çmimet aktuale ose të tërhiqet si një furnizues për materialet direkte të kompanisë. Furnizuesi hartoi një plan për të anashkaluar qëllimin e menaxherit të blerjes pa shkëlur në të vërtetë mandatin e menaxherit të blerjes. Cila nga të mëposhtmet është veprimi i mundshëm i ndërmarrë nga furnizuesi?

- a) Furnizuesi ruajti çmimet në afat të shkurtër, por më vonë u kthye në një model të rritjes së çmimeve.
- b) Furnizuesi vendosi të ndalojë ofrimin e materialeve të drejtpërdrejta për kompaninë prodhuese, pasi mbajtja e nivelit të njëjtë të çmimeve do të ketë një ndikim negativ.
- c) Furnizuesi ruajti çmimet, por zëvendësoi një shkallë më të ulët të materialeve direkte.**
- d) Furnizuesi përmes drejtorit të kompanisë prodhuese e detyroi menaxherin e blerjes të anulojë mandatin.

42. Evidenca e auditimit më bindëse në lidhje me vlerën e pasurisë së kompjuterëve të blerë do të ishte:

- a) Bisedimi me menaxhmentin
- b) Vëzhgimi i procedurave të palës së audituar
- c) Ekzaminimet fizike.
- d) Dokumentacioni i përgatitur nga jashtë.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

43. Një auditor i brendshëm fotografon vendin e punës të palës që po auditohet. Çfarë lloji i evidencës të auditimit është fotografia?
- a) **Fizike.**
 - b) Dëshmuuese.
 - c) Dokumentuese.
 - d) Analitike.
44. Gjatë një auditimit të kontrolleve të parave të gatshme, një auditor krahasoi një mostër të listave të pranimeve të parave me (1) totalin e shënimeve ditore të pranimeve të parave dhe (2) shumave të depozitave bankare ditore. Krahasimi zbuloi se (1) secila listë e arkëtimeve të parave të gatshme ishte e barabartë me hyrjet e ditore të parave, por jo shumat ditore të depozitave bankare dhe (2) gjithsej listat e pranimeve të parave të gatshme barazohen me totalin e depozitave bankare në planin afatgjatë. Për të mbështetur një konstatim që "Parat e pranuar nuk depozitohen në bankë çdo ditë", evidenca e mësipërme është:
- a) E mjaftueshme, por jo kompetente ose relevante.
 - b) **E mjaftueshme, kompetente dhe relevante.**
 - c) Jo e mjaftueshëm, kompetent ose relevante.
 - d) Relevante por jo e mjaftueshme apo kompetente.
45. Cila nga procedurat thelbësore të punës në terren të paraqitur ofron evidencat më të mira në lidhje me tërësinë e të ardhurave të regjistruara?
- a) Rakordimi i librit të shitjeve me bilancin e përgjithshëm.
 - b) Tarifat e blerjeve të regjistruara në llogarinë e llogarive të arkëtueshme për të mbështetur të dhënat e transportit.
 - c) Regjistri i kuponave të transportimit në skedarin e porosisë së klientit.
 - d) **Barazimi i regjistrimeve të transportimit me shitjet e regjistruara.**
46. Një auditor i brendshëm po kontrollon funksionin e reklamimit të kompanisë. Kompania ka angazhuar një kompani lokale të reklamave me madhësi mesatare për të vendosur reklama në botimet e revistave. Si pjesë e rishikimit të punimeve të auditimit, mbikëqyrësi i auditimit të brendshëm është duke vlerësuar evidencat e mbledhura.
- Auditori ekzaminoi kontrollat e brendshme të agjencisë së reklamave dhe, bazuar në anketën paraprake, ka përcaktuar se nuk ka probleme. Mbikëqyrësi beson se duhet të ketë evidenca thelbësore dhe ka vendosur që evidencat e mbledhura deri më tani nuk janë:
- a) Kompetent.
 - b) Relevante.
 - c) **Mjaftueshme.**
 - d) Dobishme.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

47. Për të identifikuar mungesat e artikujve specifike në një inventar të mallrave të shtrenjta të mbajtura për shitje me pakicë, hapi më i përshtatshëm i punës së auditimit është:
- a) Aplikoni metodën e shitjes me pakicë të vlerësimit të inventarit.
 - b) Krahasoni numërimin e inventarit fizik me rezultatet në regjistra të inventarit.**
 - c) Zhvillimi i vlerësime të inventarit bazuar në metodën e përqindjes së fitimit bruto.
 - d) Analizoni nivelet e qarkullimit aktual dhe të mëparshëm të inventarit.
48. Dëshmitë juridike mbështeten shumë në cilën nga këto?
- a) Dëshmitë gojore.**
 - b) Dëshmitë dokumentare.
 - c) Dëshmitë rrethimore.
 - d) Dëshmitë vërtetuese.
49. Cila nga sa vijon konsiderohet si evidencë parësore?
- a) Evidenca direkte.
 - b) Evidencat më të mira.**
 - c) Evidencat rrethimore.
 - d) Evidencat dëgjimore.
50. Cila nga evidencat e mëposhtme nuk mund të kundërshtohet?
- a) Evidenca vërtetuese.
 - b) Evidenca përfundimtare.**
 - c) Evidenca dëgjimore.
 - d) Evidenca rrethimore.